

Erdhi ariu!

Ishte dita e dyerve të hapura në kopshtin zoologjik të Berlinit dhe pikërisht sot, kujdestari i kafshëve, Pflajdereri, ndoshta për shkak të cigares së hashashit që kishte ndarë në ceremoninë festive të ditës me zotin Ëzgyntyryk të ndërtesës së kafshëve grabitqare dhe me zonjën Zyskind të sekretariatit, harroi ta mbyllte derën e gardhit të ariut polar; këtë Roald Björnsoni, ariu më i vjetër polar në shërbim, sërish e kuptoi si një ftesë për t'u trazuar mes njerëzve atje jashtë. Mbase kjo duhej pritur prej tij. Pastaj edhe ato tullumbacet e shumta e plot ngjyra!

Björnsoni doli jashtë. Prej Pflajdererit nuk kishte asnjë gjurmë. Ndaj, vizitorët i pushtoi një tronditje e madhe. Fëmijët cijatën, gratë piskatën, burrat vajtuan. Ishte sikur në atë çast të kishin zbritur Bitëllsat nga avioni. Mirëpo Björnsoni, hëpërhë, nuk kishte kohë të merrej me fansat, pasi e gjithë vëmendja e tij ishte përqendruar te një tullumbace e kaltër, që po vinte në fluturim drejt tij. Ai ngriti putrën e përparme dhe e plasi. E mrekullueshme! Një tjetër tullumbace iu rrokullis përpara, kësaj here një e kuqe, dhe ariu e ndoqi mes përmes njerëzve që rrinin në radhë, të cilët, plot respekt, i hapën vend përgjatë shëtitores së gjerë dhe përmes portës së madhe. Dhe më pas, ai u ndal befaz në bulevardin e Kurfyrstendamit. Tullumbacja vallëzoi mbi kokën e tij, mes ballinave të

ndërtesave, gjithnjë e më lart, dhe era e shtyu tutje përmbi çatitë.

Ndërsa Bjërnseni vazhdonte të shihte tullumbacen, rreth e rrotull tashmë kishte nisur të bëhej hataja. Makinat u binin borive. Autobusët u binin borive. Taksitë u binin borive. Frenat cijatnin, sirenat ulërinin. Celularët dolën nga xhepat, këmbësorët ngjisheshin pas tryezave të rrëzuara të lokaleve e pas makinave të parkuara dhe filmonin nga një largësi e sigurt.

“Ka dalë ariu!” jehonin rrugët e gjera automobilistike të Berlinit dhe rrugicat e zbrazura të internetit. Në Facebook dhe Instangram u postuan me qindra fotografi të paqarta dhe dhjetëra video të mjegullta me ariun.

Në më pak se një orë, faqja “Mbahu, Bobi!” në Facebook grumbulloi mbi 100 000 ndjekës. (Se pse dikujt i kishte shkuar në mendje ta quante ariun polar Bobi, nuk ishte e qartë, por gjithsesi emri u pranua nga një numër i madh njerëzish.)

Redaksitë virtuale të gazetave të mëdha punonin ethshëm. “Horror arinjsh në Berlin!”, ishte titulli në faqen e gazetës *Bild* në orën 13:52, që fliste për të paktën njëqind arinj që kishin mësyre në Berlin dhe kishin shkretuar një lagje të tërë.

“Arinj polarë në Berlin! Dhe ajo Greta na flet për ngrohjen e planetit?” shkroi Ulf Porshart në Twitter në orën 14:04 që nga timoni i fuoristradës së tij, i ngecur prej orësh në trafik.

Ca më e matur u tregua faqja e revistës *Der Spiegel*, në të cilën shkruhej për një kafshë të kopshtit zoologjik, e cila kishte të ngjarë të ishte arratisur. Me ç’mund të nxirrej nga regjistrimet në video, ariu dukej i ushqyer mirë, vërtet

topolak, me gëzof të bardhë borë e sy vezullues. Pra, nuk bëhej fjalë për një ari të egër polar, sepse këta dukeshin të gjithë si skelete lëvizëse, me gëzof të verdhemë, të rrahur në dërstilë, të mallkuar për t'u zhdukur mbi blloqe akulli në shkrirje e sipër dhe gjithsesi tejet të pafuqishëm për t'i bërë ballë një marshimi të gjatë për në Berlin.

Focus Online i qetësoi lexuesit/investuesit e saj, duke u bërë të ditur se bursa e kishte pritur lajmin me gjakftohtësi dhe se tregjet, hëpërhë, ishin të qëndrueshme.

Në transmetuesit publikë, ingranazhet krijuese qenë nxehur si kurrë më parë. Po atë mbrëmje, ARD-ja e ngriti çështjen në një transmetim të posaçëm nën titullin “A ka Berlioni një problem me arinjtë?”. ZDF-ja planifikoi, madje, një seri deri në ditët e festave, nën titullin “Hej, Bobi!”, në të cilën flitej për një ari polar që jeton në një familje sa të trazuar, aq edhe të këndshme në Krojcborg dhe që, me sjelljen e tij të ngathët, shkakton gjithfarësoj rrëmujash e ngatërresash. Tashmë përgjues të transmetuesit ishin vënë në kërkim Bjërnsonit, për t'i ofruar atij rolin kryesor. Ata qenë vënë në një garë me kohën, bashkë me skautë të skuadrës së hokejit në akull “Arinjtë Polarë – Berlin”, që donin t'i ngarkonin detyrën e maskotës së ekipit (dhe nëse në provat gjatë stërvitjes shfaqej premtues, ta caktonin edhe për portier të dytë).

Policia dhe ushtria qenë vënë, si gjithmonë, në krye të detyrës: menjëherë ishte krijuar një grup i gatshëm kundër terrorit të arinjve polarë, dhe kolegëve u hanin duart për të vënë në provë armët e tyre mbi material më të trashë, sesa mbi demonstrueset e demonstruesit e majtë e të gjelbër ose mbi kalamaj. Bundesveri nxori në marshim një batalion pushtash arktikë, një kompani kalorësie

me patina dhe pesë borëpastruese të blinduara të llojit “Dhëlpër polare III”. Tre helikopterë Kugar u furnizuan me lëndë djegëse dhe u dërguan në qiellin e Berlinit.

Edhe politika reagoi shpejt. Që herët pasdite, në kolona e shtylla elektrike feksën afishe me mbishkrimin:

“Ariu erdhi!

Po kush është fajtori?

Emigrantët!

Voto AfD!”

Nga radhët e Bashkimit Socialkristian doli propozimi për të ndërtuar një mur rreth Arktikut. Ose rreth Berlinit.

Pjesa më e madhe e shkollave qëndruan të mbyllura pasdite, çka bëri që ariu polar të fitonte shumë pikë mirëdashjeje mes nxënësve dhe mësuesve. Në aeroportin e Berlinit, punimet e ndërtimit u pezulluan për një kohë të pacaktuar, që punëtorët të ishin të sigurt, siç u pohua zyrtarisht.

Por jo të gjithë besonin te ariu polar. Në një deklaratë për shtyp, Shoqëria Kriptozoologjike e Europës Qendrore shprehej se njoftimet përbënin një lajm të rremë, apo *fake news*, dhe se me gjasë kishim të bënim thjesht me ndonjë tip të turbulluar, i cili kishte dalë rrugëve i maskuar me veshje të ariut polar. Do të qenkësh më mirë të përqendroheshim në një lajm më domethënës: këtë vit, në malësitë Ercgebirge ishin raportuar tri raste të shfaqjes së dragonjve. Për të mos folur pastaj për koloninë e plezozaurëve në Liqenin e Konstancës.

Po ariu polar ku gjendej ndërkohë? I hutuar prej zallamahisë që ishte krijuar përreth, Bjërnsone kishte kthyer në një rrugë dytësore të qetë dhe, prej aty, kishte

vazhduar të ecte pa ndonjë drejtim të caktuar. Ku kishte përfunduar tullumbacja e kuqe?

Ngado që shkonte, shihte me habi se njerëzit i shmangeshin, madje dukeshin sikur kishin vërtet frikë prej tij. Si përfundim, mbërriti në një lagje të quajtur Krojclauer Prenceberg. Këtu e priti një si punë komiteti. Po nuk ishte një komitet përshëndetës. Ishin nëna të shqetësuar, të cilat me karroca fëmijësh kishin ngritur një barrikadë. Kishin frikë se mos shpirtrat e brishtë të fëmijëve të tyre tmerroheshin nga pamja luftarake e ariut polar. (Ishin po ato që, në vitin 2015, kishin ngjitur mbi afishet e grupit *Iron Maiden* pusulla që tërhiqnin vëmendjen se aty pranë kishte një kopsht fëmijësh.) Kërkonin që Bjërnsoni të kishte një pamje sa më miqësore për fëmijët, përpara se të hynte në lagjen e tyre. Një maskë e madhe klouni ishte gati për të, si dhe katër pantofla të mëdha rozë prej gëzofi, bashkë me një kapelë shumëngjyrëshe me zilka. Kur Bjërnsoni vërejti edhe samarin ngjyrëvjollcë, atëherë u kthye mbrapsht. Vërtet nuk ishte njerëzrënës, por kjo nuk do të thoshte të lejonte që këta njerëz ta bënin për budalla.

Eci më tutje, në një lagje aty pranë. Gjithçka ishte krejt ndryshe. Askush nuk ia mbathte prej tij, askush nuk demonstronte kundër tij, jo, jo! Aty as që e vinin re fare.

Personi i parë që i doli përballë ishte një vajzë me çorape ngjyra-ngjyra, që mbante një dinozaur prej gome si mbulesë koke. Pastaj për pak sa nuk e përplasi një djalë i ri me mjekër, që ngiste një biçikletë kalamajsh në ngjyrë mendre.

Kryq e tërthor, rendnin rreth e rrotull njerëz me syze të mëdha e me kësula të pjerrëta, përmbi biçikleta,

njërrotëssha, trotineta, trirrotëssha, drezina.

Një në çdo dy shtëpi kishte nga një restorant ose një kafene. Bjërnsioni vëzhgonte menytë. Ishin më së shumti të shkruara me dorë dhe të ngjyrosura me ngjyra të larmishme. Për fat të keq, asnjëri prej dyqaneve të çuditshme nuk kishte dhjamë foke apo delfin të njomë në meny. Përkundrazi, shumica e tyre ishin vegetariane. Më në fund, Bjërnsioni gjeti një meny që i pëlqeu: Café Impala. Në kapak dukeshin shumë kafshë: gjirafa, zebra, derrkucë, madje edhe një rinoqeront. Kushedi se si shijonin! U ul në tarracë dhe një kamerier, i veshur me këmishë pizhamesh dhe me një palë pantallona treçerekëshe çiklistësh, e pyeti se çfarë dëshironte.

Bjërnsioni preku figurën e rinoqerontit.

Kamerieri tundi kokën dhe ia hapi menynë.

Për fat të keq, Bjërnsionit nuk i thoshin asgjë ato që paraqiteshin aty. Dukeshin si një përzierje gjuhësh të ndryshme e të zhurmshme. Ndoshta ishte babilonisht. Prandaj, thjesht tregoi diçka të çfarëdoshme.

Pesë minuta më vonë, babilonasi i solli një kavanoz reçeli me kafe që vinte aromë vaniljeje.

Bjërnsioni porositi një tjetër specialitet. Sërish i sollën kafe. Por kësaj here, vinte aromë karameli.

Pas kafesë së shtatë, nisi ta pushtonte një shqetësim i brendshëm i çuditshëm. U ngrit dhe iku pa paguar. Deshi të kthehej prapë në kopshtin zoologjik, ku e kuptonin.

Po teksa po kalonte një urë, në rrugën e kthimit për në shtëpi, i dolën përpara ata: pushtat arktikë, komandot e antiterrorit, të ndjekur nga borëpastruese të blinduara, makina me kamera dhe dy skautë të pirë të hokejtit në akull. I trembur, Bjërnsioni u kthye mbrapsht. Mirëpo

nuk shkoi dot larg. Nga ana tjetër e urës, po rrokullisej drejt tij një valë mirëdashjeje: mbrojtësit e kafshëve, të armatosur me pllakate (“Liri Bobit!”) dhe me arinj polarë prej pelushi. Ndërkohë, përmes financimit të përbashkët, ata kishin mbledhur të holla të mjaftueshme, që ariu polar të udhëtonte sërish për në Arktik.

Po kjo, a ishte gjë që bëhej?

Bjërnsioni kishte lindur e ishte rritur në këtë qytet. Nuk donte të largohej prej aty. Veç kësaj, teksa edhe dimrat e Berlinit po ia lodhnin tej mase sinuset, si do të mundej t’i bënte ballë të ftohtit arktik? I pushtuar nga paniku, kërkoi një rrugë shpëtimi. Kishte vetëm një mundësi. “Ich bin ein Berliner!” (Unë jam berlinez!), bërtiti ai. Dhe pastaj u hodh nga ura poshtë në lumin Spre.

Ishte errur, kur ariu, duke u dridhur, doli nga lumi. Ndjekësve ua kishte hedhur. Tani i duhej vetëm të gjente rrugën për në shtëpi. Eci duke u kruspullosur anës mureve gri të ndërtesave, përgjatë rrugësh që po zbrazeshin gjithnjë e më shumë prej njerëzve, ndërsa në largësi uturinjin sirena dhe dëgjoheshin të shtëna. Lagjet e qytetit, në të cilat ai shkonte, ishin të gjitha njëllor. Njëllor të stërmëdha, njëllor të zymta e monotone. Dallonin nga njëra-tjetra vetëm prej emrave të vendeve: Vedding, Moabit, Kopshti Zoologjik. Rrugë porsi shkretëtira mes ndërtesash monolite, që dukeshin sikur nuk ishin ndërtuar për njerëz, por për një racë më të madhe, më të ligë. Kështu e kishte përfytyruar gjithmonë bllokun lindor ai. Kështu jetonin ciklopët.

Ky ishte, pra, Berlini, për të cilin kafshët në kopshtin zoologjik flisnin vazhdimisht. Berlini modern, që të gjitha ato donin ta shihnin përpara se të ngordhnin. Veç

të ngjitej një herë në kullën e televizionit, ishte ëndrra e çdo dhie mali. Një “selfie” para Portës së Brandenburgut, ishte mishërimi i vetë fatit për gazelën dhe antilopën. Veç një herë të vetme të merrnin pjesë në një seancë parlamentare, do të mjaftonte për t’i bërë të kalonin në ekstazë krejt familjen e gjarpërinjve.

Kur më në fund mbërriti në kopshtin zoologjik, ku Pflajdereri ia hapi derën pa fjalë dhe po pa fjalë ia mbylli pasi hyri, Bjërnsioni vendosi që gjithçka kishte parë ta mbante për vete e të mos ua thoshte të tjerëve. Ata le të vazhdonin të ëndërronin të qetë.

Sa bukur ishte të gjendeshe sërish në shtëpi! Vështroi i kënaqur rreth e rrotull dhe i ra në sy diçka që qëndronte përtokë dhe që lëvizte lehtë tutje-tëhu prej flladit. Ishte një tullumbace e kuqe.